

Fjalët “ekskursion” dhe “pensionistë” janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën në një kontekst social, kulturor dhe turistik. Pensionistët janë grup shoqëror që shpesh kanë nevojë dhe kërkojnë mënyra për të kaluar kohën e lirë në mënyrë aktive, të shëndetshme dhe sociale

Nisur nga faktet se ekskursionet janë tejet të rëndësishme për moshat e treta, Shoqata e pensionistëve të Tetovës, këtij aktiviteti pensional, ndër vite i ka kushtuar rëndësi të madhe. Këto forma të organizimit përfshijnë një numër më të madh të pensionistëve, andaj strukturat udhëheqëse të Shoqatës vazhdimisht kanë qenë të preokupuara në organizimin dhe realizimin e një numri të madh të ekskursioneve në vend dhe jashtë shtetit. Dihet mirëfilli se ekskursionet për pensionistët kanë një rëndësi të madhe në shumë aspekte të jetës së tyre fizike, mendore dhe emocionale, andaj në këtë aktivitet pensional, gjatë vitit 2025, qoftë në ekskursione njëditore, dyditore apo treditore janë përfshirë mbi 1.700 pensionistë tetovar.

Fjalët “ekskursion” dhe “pensionistë” janë të lidhura ngushtë me

SHOQATA E PENSIONISTËVE NË TETOVË

EKSKURSIONET, RELAKSIM SHPIRTËROR E FIZIK PËR PENSIONISTËT



njëra-tjetrën në një kontekst social, kulturor dhe turistik. Pensionistët janë grup shoqëror që shpesh kanë nevojë dhe kërkojnë mënyra për të kaluar kohën e lirë në mënyrë aktive, të shëndetshme dhe sociale. Një nga aktivitetet më të dashura për ta janë pikërisht ekskursionet. Përmes këtij aktiviteti, pensionistët relaksohen, argëtohen, vizitojnë monumente kul-

ture, fetare në qytetet të ndryshme, krijojnë miqësi të reja ndërmjet pjesëmarrësve të ekskursionit, duke shkëmbyer mendime, përvoja mbi tema të organizimit pensional dhe tema të tjera nga jeta e përditshme.

Një pjesë e pensionistëve ndihen të izoluar dhe pikërisht për ta ekskursionet krijojnë mundësi për të bashkëbiseduar, për të ndarë

përvoja dhe për të krijuar miqësi të reja. Kjo formë e organizimit, gjithsesi ndihmon në rritjen e cilësisë së jetesës dhe krijon ndjesinë e përfshirjes në komunitet. Udhëtimet zakonisht përfshijnë ecje, lëvizje dhe aktivitete të lehta fizike, që janë shumë të rëndësishme për rruajtjen e shëndetit fizik.

Komisioni për pushim, rekreim dhe jetë kulturore e zbavitëse të

pensionistëve në kuadër të Shoqatës së pensionistëve të Tetovës, në Programin e përpiluar, nga viti në vit, përpiket të ndryshojë destinacionet e realizimit të ekskursioneve, në mënyrë që çdo vizitë të jetë me interes për pensionistët pjesëmarrës. Në këtë mënyrë do të vepohet edhe me Programin e ri të vitit 2026, duke përfshirë vizita në qytete dhe vendbanime të ndryshme brenda vendit dhe në shtetet fqinje. Gjithsesi, angazhimi do të jetë që pjesëmarrës të ekskursionet të jenë të gjithë pensionistët e interesuar, ndërsa përparësi të kenë ata pensionistë që realizojnë pensione të ulta dhe që kanë vështirësi sociale. Pozitën sociale të pensionistëve më së miri e njohin kryetarët e degëve vendore, të cilët Shoqata i informon në vazhdimësi për të bërë selektimin e pensionistëve pjesëmarrës të ekskursionit. Programi i ri i ekskursioneve do të jetë edhe më joshës për pensionistët, të cilët do të përcaktohen ta shfrytëzojnë këtë mundësi. Vlen të theksohet se në pjesën më të madhe të ekskursioneve, Shoqata participon për një pjesë të shpenzimeve, varësisht nga mundësitë buxhetore të saj. (M. Murseli)

SHOQATA E PENSIONISTËVE NË TETOVË

ZHELINA ME KLUB TË PENSIONISTËVE

Kryetari i Komunës së Zhelinës, Blerim Sejdiu falënderoi ministrin Limani për angazhimin e tij rreth hapjes së klubit, ndërsa premtoi se komuna gjithmonë do të jetë afër pensionistëve, për t'u ndihmuar në zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Me grantin e fituar nga kjo ministri do të mundësohet furnizimi i ambientit të kësaj qendre me pajisjet e nevojshme për punë

Më 16 tetor të vitit 2025, në qendër të fshatit Zhelinë, me një ceremoni rasti u hap klubi i ri i pensionistëve, i cili ambient do të shërbej për ushtrimin e veprimtarive të moshave të treta të Zhelinës dhe vendbanimeve të kësaj komune rurale. Në këtë solemnitet për krahas pensionistëve të kësaj dege ishin të pranishëm ministri për Punë, Politikë sociale, demografi dhe të rinj, Fatmir Limani dhe kryetari i komunës së Zhelinës, Blerim Sejdiu.

Në fjalën e tij ministri Limani, pasi përshëndeti pensionistët e pranishëm tha se ky ambient do të shërbej për moshat e treta, të cilët do të kenë një ambient të qëndrimit ditor për realizimin e programeve të tyre të punës. Ministria

e Punës dhe Politikës sociale do të kujdeset edhe për furnizimin e kësaj qendre me pajisjet e nevojshme, në mënyrë që pensionistët të kenë kushte ideale për punë, nënvizoi ministri Limani.

Nga ana tjetër, kryetari i Komunës së Zhelinës, Blerim Sejdiu falënderoi ministrin Limani për angazhimin e tij rreth hapjes së klubit, ndërsa premtoi se komuna gjithmonë do të jetë afër pensionistëve, për t'u ndihmuar në zhvillimin e aktiviteteve të tyre. Me grantin e fituar nga kjo ministri do të mundësohet furnizimi i ambientit të kësaj qendre me pajisjet e nevojshme për punë. Kjo do të ndodhë deri në vitin e ri nënvizoi Sejdiu. Kujdesi ndaj tyre nuk do të mun-

gojë asnjëherë, sepse gjithçka që kemi është vepër e moshave të treta, tha midis tjerash Blerim Sejdiu, kryetar i komunës së Zhelinës.

Anëtar i Këshillit ekzekutiv të SHP-Tetovë nga dega e Zhelinës, Muedin Huseini duke iu drejtuar të pranishmëve midis tjerash tha:

“Pas një iniciative të nisur nga pensionistët e komunës së Zhelinës që para 5 vjetësh, me angazhimin e ministrit dhe kryetarit të komunës po realizohet një projekt shumë i rëndësishëm për moshat e treta të këtij rajoni. Hapet klubi i pensionistëve, në të cilin ambient, tash e tutje do të organizohen dhe realizohen shumë aktivitete të organizimit pensional. Falënderoj ministrin Limani dhe



kryetarin e komunës Sejdiu që sot po bëhet realitet një angazhim që ata morën përsipër para disa kohësh.

Tash e tutje pensionistët e vendbanimeve të komunës së Zhelinës e kanë selinë e tyre, ku do të organizohen mbledhje dhe shumë aktivitete të parapara me programet tona të punës. Ky ambient është i rëndësishëm edhe për Shoqatën e pensionistëve të Tetovës sepse jemi të sigurt që lidhja jonë me pensionistët tetovar do të jetë shumë më e ngushtë për koordini-

min e të gjitha aktiviteteve”, tha midis tjerash Useini. Zhelina është e vetmja komunë rurale e rajonit të Tetovës që bëhet me klub të pensionistëve, ndërsa nuk do të mungojë angazhimi për hapjen edhe të klubeve të tjera në qytetin e Tetovës dhe vendbanimet përreth.

Vlen të theksohet se vitin e kaluar nga ana e Lidhjes së Shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë, dega e pensionistëve të Zhelinës u shpall në mesin e katër degëve më aktive në vend.